

SHTOJCA 1**Formulari i kërkesës për leje mjedisore**

Emri i kompanisë	V - KASTRTI SH.P.K.
Lloji i veprimtarisë	IMPIANTI PËR PRODHIMIN E BETONIT
Vendi/lokacioni ku zhvillon veprimtarinë	Gorazhdec- PEJË
Emri, mbiemri dhe nënshkrimi i personit përgjegjës si dhe vula e kompanisë	Sami Kastrati
Adresa	Gorazhdec- PEJË
Telefoni , fax, e-mail	044140213 sami_kastrati@hotmail.com
Emri dhe mbiemri i personit kontaktues përgjegjës për mjedis	Sami Kastrati
Adresa	Gorazhdec- PEJË
Përshkrimi i dokumentacionit të bashkëngjitur kërkesës përfshirë numri e protokollit të dokumentit, datën e lëshimit dhe skadimit	1. Certifikatë biznesi NUI NUI 810200717 06.02.2007. 2. Vendim i Pëlqimit Mjedisor, Nr.: 21/2625 DATE; 08.06.2022 3. Leje ujore për shfrytëzimin e ujërave Nr.:4903/20 ZPS 2021 4. Leje ujore për Shkarkimin e ujërave Nr.: 3991-2/19 ZPS 2021 5. Licenca KPMM 965/2025
Deklarimi i vlerës financiare të investimit të projektit (euro), nënshkruar nga personi përgjegjës i kompanisë	Po
Fatura e pagesës së tarifës për leje mjedisore	Po
Aplikacionin origjinal të plotësuar për Leje Mjedisore në pesë (5) kopje fizike dhe një (1) elektronike (CD).	Po

SHTOJCA 2

APLIKACION PËR DHËNJEN E LEJËS MJEDISORE		
1. TE DHËNAT E PËRGJITHSHME		
1.1. Të dhënat për Operatorin		
1.1.1.	Emri i subjektit	V - KASTRTI SH.P.K.
	Vendi	Gorazhdec- PEJË
	Adresa	Gorazhdec- PEJË
	Nr. i tel./fax	049134820
	E-mail	sami_kastrati@hotmail.com
1.1.2.	Numri i regjistrimit të biznesit, data e regjistrimit	NUI 810200717 06.02.2007
1.1.3.	Personi përgjegjës i kompanisë	Sami Kastrati
	Nr. i tel./fax	049134820
	E-mail	sami_kastrati@hotmail.com
1.1.4.	Personi kontaktues përgjegjës për mjedis	Sami Kastrati
	Nr. i tel./fax	049134820
	E-mail	sami_kastrati@hotmail.com
1.2. Të dhënat për impiantin		
1.2.1.	Emri i impiantit	IMPIANTI PËR PRODHIMIN E BETONIT

1.2.2.	Adresa e lokacionit të impiantit	Gorazhdec- PEJË
2. TË DHËNAT PËR LOKACIONIN E IMPIANTIT		
2.1.	Të dhënat për lokacionin ku zhvillohet veprimtaria sipas hartës së bashkangjitur	Vendosjes se Betonores shtrihet ne pjesën e ngastres P-71611020-00210-1 me sipërfaqe prej S = 8049.9 m² Lokacioni për prodhimi i betonit gjendet në lokacionin e quajtur Gorazhdec Pejë dhe shtrihet në një distancë rreth 850m nga rruga magjistrale Prishtinë – Pejë, ne anen e majte të magjistrales. Konfiguracioni i reliefvit ku janë të vendosura pajisjet për prodhimin e betonit është e rrafshët me një lartësi të butë mbidetare. Bazuar në të dhënat e gjeodetëve të licencuar këtë e bënë të një rëndësie të veçante për prodhimin e betonit, pa bërë ndonjë dëm apo pengesë të çfarëdo lloji në raport me mjedisin.





Figure 1. Territori i komunës së Pejes ne hartën e Kosovës

		 Figura 2. Pamje e lokacionit te impiantit.
2.2.	Numri kadastral i parcelës	Në aspektin administrativ kjo zonë shtrihet në ngastren kadastrale P-71611020-00210-1, Zk Gorazhdec, Peje.
2.3.	Përshkrimi i lokacionit të gjitha objektet dhe aktivitetet e tyre në atë zonë	Pozita e lokacionit te Betonares ka një pozitë të përshtatshme gjeografike dhe ka formë të rregullt dhe shtrishmëri verilindje – jug përmendim. Ky lokalitet kufizohet në veri, në jugë, lindje dhe perëndim me pronat private të qytetarëve të fshatit.

Lokacioni ka lidhje të mira komunikacioni si dhe infrastrukturë rrugore e cila e lehtëson transportin, si të lëndës së parë, po ashtu edhe të produkteve finale (betonit të gatshëm). Lokacioni gjendet pranë rrugës regionale që lidh qytetet si; Pejë – Prishtinë dhe një qasje të mirë në K. Pejës. Betonjerka është gjendet rreth 8.5 km në veri-lindje të Pejës. Në afërsi të betonares nuk ka ndonjë objekt banim a po industrial, mirëpo një numër i objekteve janë mbi distancën 180m





Figura 3. Pamje e distancës se parcelave ku do të ndërtohet impianti dhe shtëpive për rreth

2.4.	Të dhëna lidhur me florën dhe fauna në atë lokacion	Duke marrë parasysh karakteristikat e gjendjes ekzistuese mund të konstatojmë se regjioni i analizuar nuk ka potenciale të cilat janë me statusin e veçantë të mbrojtjes të cilat mund të rrezikohen me funksionimin i betonares për prodhimin e betonit. Flora Lokacioni ku është vendosur impianti i betonit në aspektin morfologjik është një rrafshë, me zona te arave bujqësore dhe me shtepi banuse, pra flora është e zakonshme. Fauna Gjendja ekzistuese e llojeve të shtazëve në mardhënje me regjionin e analizuar, janë konstatuar me vëzhgimin e drejtpërdrejtë në terren dhe është vu në përfundim se hapësira e analizuar është e populluar me lloje të shtazëve të egra dhe shtëpiake. Prej insektengrënësve kemi parë gjurmë të Iriqit (<i>Erinaceus europaeus</i>) dhe urithit (<i>Talpa europaea</i>). Prej gjitarëve konsideroj së në pyllin përreth gjendet lepuri, dhelpen.
2.5.	Të dhënat mbi zonat e veçanta të mbrojtjes	Lokacioni ku gjendet impianti i betonit, Sipas Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, por edhe sipas observimeve në terren nuk kemi ndonjë zone te veçanta.

3. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE MBI VEPRIMTARINË		
3.1.Përshkrim i aktivitetit për të cilën kërkohet Leja Mjedisore		
3.1.1	Skema e procesit teknologjik	Skema e procesit teknologjik është në shtojcën 1 të aplikacionit

		
3.1.2.	Përshkrim i pajisjeve dhe fazat e procesit teknologjik	PROCESI TEKNOLOGJIK NË IMPIANTIN E BETONIT Impianti për prodhimin e betonit i kompanisë V-KASTRATI përbëhet nga këto objekte dhe pajime:

		Linja e prodhimit te betonit perbehet nga : • Vendi i depozitimit te materialeve inerte • “Pandus” per transportin e inerteve ne bunkerin e inerteve • Transportieret e inerteve • Lenda e pare: Inerte te perpunuara • Kapaciteti prodhues: 40 m²/orë • Procesi: Zinxhir • Fuqia e instaluar: 40 kë • Sillosi i cimentos • Depozite e ujit • Salla e komandimit • Zyrat (Magazine) Pjeset perberese te kesaj linje jane: Sheshi i prodhimit e te cilet jane montuar linja e pergatitjes se betoneve. Ne kete ambjent perfshihen dhe sheshi i depozitimit te lendeve inerte te perpunuar qe furnizohet (inerte lumi te perpunuara) Godina e cila ka aparaturat e komandimit te kesaj linje. Projekti ka parashikuar paisjete te gjithë objektit me kanalizimet e nevojshme te ndara vecmas si per ujerat e sherbimeve ne teknologji ashtu dhe per nevojat sanitare. Uji teknologjik siguriohet ngapusi i hapur nga pronari i kesaj shoqerie. Shkarkimi i ujerave te bardhave eshte projektuar nepermjet kanaleve te derdhet ne kanalet e ujerave te bardha te kesaj zoneduke ndertuar nje grop sedimentimi perpara se te shkojne ne keto kanalizime. Kjo siperfaqe ku eshte ndertuar ky objekt lidhet me rrugen kryesore. Betoniera është adekuate për prodhimin e betonit dhe i përgjigjet ISO standardeve.
--	--	---

Baza e betonit me pajimet përcjellëse për realizimin procesit teknologjik për prodhimin e llojeve të betoneve është e prodhuar në Turqi.



Foto. Pamje e betonares.

		Koncepti prodhues i betonit Kompania jone, bene prodhimin e betonit me teknologji dhe pajime të cilat mundësojnë prodhimin e të gjitha llojeve të betonit dhe me cilësi të lartë. Në procesin e prodhimit të betonit, përdoren materialet: çimentoja, fraksionet e gurit / rërës, uji dhe aditivët. Fraksionet e gurit / rërës të cilat do të përdoren janë: : Fr-I (0-4)mm X 2 copa. ,Fr-II (4-8)mm. Fr-III(8-16)mm dhe Fr-IV(16-32)mm. Teknologjia që përdoret, ofron mundësi të aplikimit të një procesi të mbyllur, me mundësi kontrollimi në mënyrë automatike, çka mundëson ndikime më të vogla në mjedis, si dhe eficientë në përdorim të lëndës së parë. Prodhimi i betonit Betoni paraqet konglomerat që përfitohet me përzierjen e çimentos, fraksioneve të gurit, dhe ujit. Kompania bene këto lloje të betoneve, varësisht prej kërkesave të tregut: • Beton Plastik 0-16 (MB15, MB20, MB25, MB30, MB35, MB35) • Beton Plastik 0-31.5 (MB10, MB15, MB20, MB25, MB30, MB35, MB 40) • Beton i ajruar 0-16 (MB20, MB25, MB30, MB35, MB 40) • Beton i ajruar 0-31.5 (MB20, MB25, MB30, MB35, MB 40) • Beton i qëndrueshëm ndaj ujit 0-16 (MB20, MB25, MB30, MB35) • Beton i qëndrueshëm ndaj ujit 0-31.5 (MB20, MB25, MB30, MB35) Përveç llojeve të përmendura më lart, varësisht prej kërkesave të tregut, prodhohen edhe lloje të tjera të betoneve për ndërtimin e rrugëve, urave, tuneleve, infrastrukturës nën ujore etj.
--	--	--

		Përshkrimi i procesit teknologjik Procesi fillon me depozitimin e lëndës së parë, në lokacione – objekte përkatëse. Fraksionet e agregatit, sipas porosisë, depozitohen në depon e agregatit, dhe pastaj me makineri përkatëse – lugë ngarkuese vendosen në silosin (bunkerin) e agregatit me kapacitet 60 m³, sipas fraksioneve. Çimentoja e siguruar vendoset në dy siloset me nga 100 tona, ndërkaq uji në rezervuarin e ujit 10 000 litra. Natyrisht në sistem bëjnë pjesë edhe pompa për furnizim me ujë si dhe pajisje elektrike automatike të dozimit. 1. Agregatet e vendosura në silos sipas fraksioneve, dozohen përmes dozuesve elektropneumatik, të cilët hapen dhe mbyllen në mënyrë automatike varësisht nga komanda e dhënë, dhe njëkohësisht bëjnë matje e peshës së agregatit. Sasia e caktuar e agregatit kalon në shiritin transportues, i cili ndodhet nën siloset e agregatit, dhe i cili e transporton agregatin deri te shiriti kryesor, e që ky i fundit e përcjell lëndën deri në mikser. 2. Dozimi i çimentos bëhet përmes peshores automatike për matjen e peshës, si dhe transportohet përmes transportuesit kërmillor nga silosi. Çimentoja nga peshoja kalon në mënyrë automatike. Gjatë zbrazjes së peshojës së çimentos, aktivizohen vibruesit, të cilët sigurojnë që e gjithë sasia e çimentos të jetë larguar nga peshorja. 3. Edhe dozimi i ujit bëhet në mënyrë automatike, me dozim të programuar përmes pompës së ujit. Pas kalimit të sasisë së programuar të ujit, ventili mbyllet në mënyrë automatike.
--	--	---

		E tërë lënda e programuar dhe e peshuar; agregati nga siloset, përmes shiriti transportues e deri në shiritin kryesor; çimentoja gjithashtu nga peshorja, përmes gypit transportues e deri në shiritin kryesor, e gjithashtu edhe uji i programuar dhe dozuar, shkarkohen në mikser (përzierës). Pajimet funksionojnë në mënyrë automatike me dozim të programuar, por gjithashtu mund të funksionojnë edhe në mënyrë manuale. Menaxhimi i tërë procesit kryhet nga kabina e kontrollit, përmes pultit automatik komandues. Modulet hyrëse drejtpërdrejtë pranojnë sinjalet nga dozatorët dhe peshoret. Modulet digjitale dalëse, shërbejnë për menaxhimin e ventileve elektromagnetik, motorëve si dhe llampave sinjalizuese. Përveç materialeve kryesore, agregatit, çimentos dhe ujit, në proces përfshihen edhe aditivët. Sidomos në sezonën e dimrit, si dhe për konstruksione të veçanta shtohen aditiv të cilët e shpejtojnë kohen e ngurtësimit. Aditivi kryesisht shtohet me ujë, ose drejtpërdrejtë në mikser. Zakonisht aditivët shtohen në masën 2-4% të masës së çimentos. Para se të lëshohen pajimet për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit, duhet të kryhen këto veprime;  Duhet të sigurohet sasia e mjaftueshme e agregatit në silose.  Duhet të sigurohet sasia e mjaftueshme e çimentos dhe duhet hapur vetëm ventilin e silosit nga i cili dëshirojmë të marrim çimento.  Duhet të sigurohet sasia e nevojshme e ujit.  Duhet caktuar recepturën për kualitetin e betonit të cilin dëshirojmë të e prodhojmë
--	--	--

		🚧 Të caktohet zgjatja e kohës së ciklit të prodhimit të betonit duke u bazuar në recepturën e caktuar. Pajimet mund të funksionojnë në mënyrë automatike me dozim të programuar dhe në mënyrë manuele. Menaxhimi i procesit teknologjik i prodhimit të betonit, kryhet nga pulti komandues i automatizuar i vendosur në dhomën (hapësirën) të caktuar për te. Modulet hyrëse drejtpërdrejt pranojnë sinjalet nga dozatorët dhe peshojat, nëpërmjet sondave për të gjithë komponentët e procesit të prodhimit. Modulet digjitale dalëse shërbejnë për menaxhimin e ventileve elektromagnetikë, motorëve si dhe llampave sinjalizuese. Menaxhimi i ter procesit të prodhimit behet edhe përmes disa monitorëve të vendosur në panelin e komandimit, përmes këtij paneli operatorit i mundësohet të bëj mbikëqyrjen e tërë procesit dhe recepturat për prodhimin e betonit, me këtë mundësohet matja lehtë e komponentëve të agregatit, bitumenit dhe komponentëve tjera shtesë. Për të arritur cilësinë e duhur të betonit bëhet sitja e çimentos me sita standarde dhe përcaktohet kohëlidhja e sajë. (Kohëlidhja e çimentos paraqet kohën nga momenti i përzierjes së çimentos me ujë gjer në momentin e fillimit të hidratimit të sajë dhe arritjes së fortësisë përkatëse).
3.1.3.	Numri i orëve të punës dhe ditëve të punës gjatë javës për kryerjen e aktiviteteve	Orai i punes nga ora; 08:00 deri ne 16:00 (<i>ne varesi te kërkesave per beton mund edhe te zgjatet</i>) =48 ore ne jave Ditë të punës janë 6, nga e Hëa deri të Shtunën (e Dile pushim)
3.1.4.	Kapaciteti i projektuar dhe kapaciteti i realizuar, ditor, mujor, vjetor	Kapaciteti i prodhimit të betonit 50m ² /orë, realizohet në varesi të kërkesave.
3.1.5.	Të dhënat për shfrytëzimin e lëndës së parë dhe lendeve ndihmëse, energjisë, uji, etj.	Komponentët hyrëse gjatë aktiviteteve që zhvillohen në impiantin per prodhimin e betonit.

		Komponentët e betonit. <u>Çimentoja</u> – paraqet komponentin lidhës të betonit. Kryesisht do të përdoret çimentoja “Portland”, por varësisht prej kërkesave të tregut mund të përdoren edhe lloje të tjera të çimentos. Cilësia e çimentos përcaktohet në bazë të aftësisë lidhëse, e cila shprehet përmes fortësisë. Kështu dallohen disa lloje të fortësisë: 200, 320, 500, 600 dhe 800 kp/cm². Sasia për prodhimin e betonit, përkatësisht harxhimi specifik i çimentos është 200-400 kg /1m³. <u>Agregati – guri / rëra.</u> Kompania furnizohet me fraksionet e gurit gëlqeror nga kompani të, licencuara, materialet e të cilit janë dëshmuar për cilësi. Agregati duhet të përmbushë kushtet e parapara në cilësi dhe granulim, duhet të jetë i pastër dhe me përbërje të lartë të kuarcit. Agregati duhet të jetë pa asnjë shtesë e cila do të mund të reagojë me ujin dhe të shkaktojë shkapërderdhje, sikurse që janë kloridet, sulfatet dhe kompozimet tjera kimike që mund të dëmtojnë vetitë fizike dhe mekanike të betonit. <u>Uji</u> – është komponent i rëndësishëm në procesin e prodhimit të betonit, i cili shërben për të realizuar lidhjen e komponentëve të tjera, çimentos dhe agregatit. Investitori, siguron ujin nga pusi privat, dhe përmes depozitimit të rezervave të ujit në rezervuar. Në procesin e prodhimit të betonit, përdoret vetëm ujë i pastër, pa materie organike.
--	--	---

		Harxhimi specifik i ujit në procesin teknologjik për prodhimin e betonit varet nga lloji i betonit që dëshirojmë të prodhojmë. Në vijim do të i pet përqindja e ujit në beton në varësi nga lloji i betonit: - për beton të lëngshëm 6- 8% - për beton plastik 7- 9% - për beton të fortë plastik 8-10% Siç kemi cekur ne pasuset e më sipërme ne këtë betonier mund të prodhojmë beton të kualiteteve të ndryshme duke u bazuar ne destinimin e tij dhe atë sipas nevojës dhe kërkesave të hargjuesve të betonit. Në tabelën e më poshtme po e japim një shembull që paraqet sasinë e agregatit sipas fraksioneve dhe atë pa fraksionin +16-31.5mm, sasinë e çimentos dhe sasinë e ujit që nevojitet për prodhimin e 1m3 beton llojit MB-30, sipas recepturës së caktuar: Agregati <table><tr><td>Fraksionet</td><td>+0-4mm</td><td>+4-8mm</td><td>+8-16mm</td><td></td></tr><tr><td>Përqindja</td><td>45%</td><td>20%</td><td>35%</td><td></td></tr><tr><td>Sasia</td><td>824kg</td><td>366kg</td><td>642kg</td><td>= 1932kg</td></tr><tr><td>Çimentoja</td><td></td><td></td><td></td><td>350kg</td></tr><tr><td>Uji</td><td></td><td></td><td></td><td>238kg</td></tr></table> Nga kjo recepturë e lartshënuar mund të caktohet edhe bilanci material për prodhimin e 1m3 beton që shihet në tabelën e më poshtme; <table><tr><td>Hyrja</td><td>Dalja</td></tr></table>	Fraksionet	+0-4mm	+4-8mm	+8-16mm		Përqindja	45%	20%	35%		Sasia	824kg	366kg	642kg	= 1932kg	Çimentoja				350kg	Uji				238kg	Hyrja	Dalja
Fraksionet	+0-4mm	+4-8mm	+8-16mm																										
Përqindja	45%	20%	35%																										
Sasia	824kg	366kg	642kg	= 1932kg																									
Çimentoja				350kg																									
Uji				238kg																									
Hyrja	Dalja																												

		<table><tr><td>Agregati</td><td>1832kg</td><td rowspan="4">1m³ beton</td><td rowspan="4">2420kg</td></tr><tr><td>Çimentoja</td><td>350kg</td></tr><tr><td>Uji</td><td>238kg</td></tr><tr><td>Bilanci i përgjithshëm</td><td>2420kg</td></tr></table>	Agregati	1832kg	1m³ beton	2420kg	Çimentoja	350kg	Uji	238kg	Bilanci i përgjithshëm	2420kg																							
Agregati	1832kg	1m³ beton	2420kg																																
Çimentoja	350kg																																		
Uji	238kg																																		
Bilanci i përgjithshëm	2420kg																																		
		Në tabelën ne vijim po e japim një shembull për sasinë e agregatit sipas fraksioneve dhe atë me katër fraksione, sasinë e çimentos dhe sasinë e ujit që nevojitet për prodhimin e 1m3 beton llojit MB-30, sipas recepturës së caktuar: Agregati <table><tr><td>fraksionet</td><td>+0-4mm</td><td>+4-8mm</td><td>+8-16mm</td><td>+16-31,5 mm</td></tr><tr><td>përqindja</td><td>40%</td><td>15%</td><td>35%</td><td>25%</td></tr><tr><td>sasia</td><td>795kg</td><td>355kg</td><td>430kg</td><td>520kg</td><td>=</td><td>2100kg</td></tr></table> Çimentoja 380kg Uji 230kg Nga kjo recepturë e lartshënuar mund të caktohet edhe bilanci material për prodhimin e 1m3 beton që shihet në tabelën e më poshtme. <table><tr><td colspan="2">Hyrja</td><td colspan="2">Dalja</td></tr><tr><td>Agregati</td><td>2100kg</td><td>1m3 beton</td><td>2710kg</td></tr><tr><td>Çimentoja</td><td>380kg</td><td></td><td></td></tr><tr><td>Uji</td><td>230kg</td><td></td><td></td></tr></table>	fraksionet	+0-4mm	+4-8mm	+8-16mm	+16-31,5 mm	përqindja	40%	15%	35%	25%	sasia	795kg	355kg	430kg	520kg	=	2100kg	Hyrja		Dalja		Agregati	2100kg	1m3 beton	2710kg	Çimentoja	380kg			Uji	230kg		
fraksionet	+0-4mm	+4-8mm	+8-16mm	+16-31,5 mm																															
përqindja	40%	15%	35%	25%																															
sasia	795kg	355kg	430kg	520kg	=	2100kg																													
Hyrja		Dalja																																	
Agregati	2100kg	1m3 beton	2710kg																																
Çimentoja	380kg																																		
Uji	230kg																																		
3.1.6.	Lista e rezervuarve dhe kapaciteti i tyre	Kompani nuk posedon rezervuar.																																	

3.1.7.	Lista e legjislacionit ne fuqi	Lista e Ligjeve dhe Udhëzimeve Administrative për kompletimin e kërkesës për lëshimin e Lejes Mjedisore LIGJET ➤ <i>LIGJI NR.03/L-025 PËR MBROJTJEN E MJEDISIT</i> ➤ <i>LIGJI I PLANIFIKIMIT NR. 04 / L-174</i> ➤ <i>LIGJI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT NR. 03/L-025</i> ➤ <i>LIGJI NR. 03/L-230 PËR VLERËSIMIN STRATEGJIK TË NDIKIMIT NË MJEDIS (VSNM)</i> ➤ <i>LIGJI NR. 08/L-025 PËR MBROJTJEN E AJRIT NGA NDOTJA</i> ➤ <i>LIGJI PËR UJËRAT E KOSOVËS NR. 04/L-147</i> ➤ <i>LIGJI PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR NR. 04/L-174</i> ➤ <i>LIGJI NR. 08/L-071 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.04/L-060 PËR MBETURINA</i> ➤ <i>LIGJI NR. 08/L-181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS (VNM)</i> ➤ <i>LIGJI NR. 08/L-116 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-197 PËR KIMIKATE</i> ➤ <i>LIGJI NR. 03/L-233 PËR MBROJTJEN E NATYRES</i> ➤ <i>LIGJI NR. 02/L-102 PËR MBROJTJEN NGA ZHURMA</i> ➤ <i>LIGJI NR. 04/L – 110 PËR NDËRTIM</i> ➤ <i>LIGJI NR. 04/L-175 PËR INSPEKTORATIN E MJEDISIT, UJËRAVE, NATYRËS, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE NDËRTIMIT</i> ➤ <i>LIGJI NR. 04/L-161 PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË</i>
--------	--------------------------------	--

		➤ LIGJI NR. 08/L-071 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.04/L-060 PËR MBETURINA ➤ LIGJI NR. 04/L-012 PËR MBROJTJE NGA ZJARRI ➤ LIGJI NR. 08/L-112 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 02/L-26 PËR TOKËN BUJQËSORE ➤ LIGJI NR. 2003/3 PËR PYJET E KOSOVËS, NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 03/L-153 ➤ LIGJI NR. 02/L-88 PËR TRASHËGIMINË KULTURORE ➤ LIGJI NR.05/L-081 PËR ENERGJINË ➤ LIGJI NR.05/L-085 PËR ENERGJINË ELEKTRIKE ➤ LIGJI NR.05/L-084 PËR RREGULLATORIN E ENERGJISË ➤ LIGJI NR. 08/L-214 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.03/L-163 PËR MINIERAT DHE MINERALET I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 04/L-158 <i>Udhëzimit Administrative</i> ➤ <i>Udhëzimi administrativ Nr.04/2022 për Leje Mjedisore</i> ➤ <i>Udhëzimi administrativ Nr. 20/2011 për metodologjinë e zvogëlimit të rrezikut nga aksidentet kimike dhe masat për eliminimin e pasojave</i> ➤ <i>Udhëzimi administrative Nr.07/2014 kompetencat e zotëruesit dhe operatorit për trajtimin e mbeturinave</i>
--	--	--

		➤ <i>Udhëzimi administrativ Nr. 20/2011 për Pengimin e aksidenteve të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme</i> ➤ <i>Udhëzim administrativ (mzhe) nr. 03/2017 mbi rregullat për zonat e sigurisë</i> ➤ <i>udhëzim administrativ (mmphi) nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor</i> ➤ <i>udhëzim administrativ (qrk) nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes</i> ➤ <i>Udhëzim administrativ (mmph) nr.16/2015 për informim, pjesëmarrje të publikut dhe palëve të interesuara në procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis</i> ➤ <i>Udhëzimi administrativ (QRK)-Nr.03/2021 për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme</i> ➤ <i>Udhëzimi administrative Nr.30/2014 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor</i> ➤ <i>Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.07/2021 mbi rregullat dhe normat e shkarkimeve ne ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes</i> ➤ <i>Udhëzimi administrativ Nr. 01/2017 për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës</i> ➤ <i>Udhëzimi Administrativ për vlerat kufizuese te efluentit që shkarkohet në trup ujqor dhe në rrjetin e kanalizimit publik.</i> • UDHËZIM ADMINISTRATIV (MMPHI) NR. 01/2025 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MMPHI) NR. 04/2022 PËR LEJE MJEDISORE
--	--	--

3.2. Menaxhimi i Mbrojtjes së Mjedisit		
3.2.1.	Sistemi menaxhues i mbrojtjes së Mjedisit	Kompania jone është i përkushtuar më të gjitha funksionet e sajë organizative në përmirësimet e vazhdueshme që të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore për të pasur një mjedis të pastër dhe të qëndrueshëm. Sistemet e Menaxhimit Mjedisor bazuar në ISO 14001 japin mundësinë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një organizate me synim: 1. Parandalimin e dëmtimit të mjedisit 2. Përmirësimin e komunikimit me autoritetet 3. Përmirësimin e vazhdueshëm i mjedisit 4. Respektimin e legjislacionit vendor
3.2.2.	Raportimi	Kompania do të raportojë në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke respektuar kërkesat – kushtet që derivojnë pas pajisje me Leje Mjedisore duke i raportuare autoriteteve mjedisore sipas legjislacionit në fuqi.

4. AJRI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE		
4.1.	Pikat e burimit të emisioneve të materieve ndotëse	Shkarkimet në mjedis gjatë funksionimit të impiantit për prodhimin të betonit do të jenë kryesisht pluhuri i lëndës së parë si granil, rrëre dhe gjate procesit të impiantit dhe në rast të mundshëm derdhje të cimentos në sheshin e prodhimit si dhe Pluhurat të

		cilët lirohen nga automjetet të cilat qarkullojnë brenda hapsires punuese dhe pluhuri i cili mund te shkaktohet ne rast te erareve e qe burim mund te jetet deponia e zhavorrit.
4.2.	Ndikimi i materieve ndotëse në cilësinë e ajërti	Ndikimi i emisionit të materieve ndotëse në cilësinë e ajrit varet para se gjithash nga kushtet klimatike -meteorologjike, numri i automjeteve të cilat qarkullojnë brenda hapsires punuese te impiantit. Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër, gjatë procesit të punës, ku operojnë makinerit transportuese kompania, ka ndërmerren këto masa: Jane vendosur filtrat per emitimin e pluhurit ne atmosfer dhe e gjithë hapsira punuese e impiantit spërkatet me ujë posaçërisht në kohëra me erëra dhe me temperatura të larta dhe mirëmbahet nga mbeturinat tjera.
4.3.	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse paraqiten nga pluhurat të cilët lirohen nga qarkullimi i automjeteve të cilat qarkullojnë brenda hapsirës punuese dhe gjatë procesit teknologjik.
4.4.	Pajisjet për trajtimin e gazrave shkarkuese	Kompania jone nuk ka pajisje për trajtimin e gazrave shkarkuese pasi që ky impiant nuk percillet me emimison të gazrave shkarkuese.
4.5.	Pajisjet për de - pluhurim	Kompania nuk ka pajisje per deplurim, vetem se i ka vendosur filtrat betonares per parandalimin e pluhrit.
4.6.	Monitorimi i emisioneve	Jane bo matjet nga instituti i INKOS Sh.A.

4.7.	Monitorimi i emisioneve/cilësisë së ajrit	Kontrollin e rregullt do ti relaizoj Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinore dhe Infrastruktures, permes organeve të saj, ndersa matjet do ti bëjë kompania vetem ne raste te veçanta MMPHI-ja.
4.8.	Raportimet	Kompania ende nuk bën raportime në MMPHI, mirëpo nëse kërkohet në të ardhmen do të raportojë, duke respektuar kërkesat e autoriteteve mjedisore dhe legjislacionin në fuqi.
4.9.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit	Për të parandaluar dhe zvogëluar ndikimet negative në ajër gjatë fazës së operimit, përkatësisht prodhimit të betonit jane ndërmerre këto masa: ➤ Pluhuri i cili lirohet gjatë procesit teknologjik të prodhimit eshte mënjanuar deri në kufijtë minimal dhe pa ndikime në mjedis dhe shëndet; ➤ Jane vendosur filtrat per te ndaluar emitimin e pluhurit ne atmosfer ➤ Shiritat transportues të fraksioneve janë të mbuluar, dhe të mirëmbajtur; ➤ Gypat për mbushje të siloseve me çimento, si dhe gypa për mbushjen e mikserit me çimento kontrollohen nga personi pergjegjes i kompanise; ➤ Thasët e filtrave të kontrollohen rregullisht; ➤ Bëhet kontrolli i rregullt teknik i automjeteve transportuese; ➤ Vazhdimisht spërkaten me ujë platoja operationale, aty ku ka potencial për pluhur, sidomos gjatë kohës me erëra dhe me temperatura të larta. ➤ Si dhe masat tjera.
4.10.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ndryshimet klimatike	Për ta parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative ne ndryshimet klimatike lokale, i kemi marre këto masa qe jane; rrugët ku behet transportimi i masës se rërës dhe zhavorrit

		mirëmbahen vazhdimisht të spërkatet me ujë, behet kontrollimi i rregullt i automjeteve të renda dhe konsumuesve tjerë me lëndë të lëngëta djegëse me qëllim të zvogëlimit të emisioneve në ajër.
5. UJI		
5.1.	Të dhënat për shfrytëzimin e ujit	Në lokacioni ku vepron kompani kemi hapur pusin e ujit, uji të cilin e përdorë për nevoja vetanake. Përdorimi i ujit përdoret për nevoja sanitare si dhe në procesin teknologjik.
5.2.	Të dhënat për shkarkimin e ujërave, shkarkimet në ujërat sipërfaqësore apo në rrjetin e kanalizimit	Shkarkimi i ujërave nga procesin teknologjikë trajtohet nga gropa septike të cilat janë ndërtuar. Shkarkimi i ujërave sanitare bëhet në rrjetin e kanalizimit të fshatit.
5.3.	Ndikimet në ujë	Gjate operimit të impiantit për prodhimin e betonit nga kompania në fjalë duhet të kenë kujdes në ndikimet e mundshme në ujë. Shkarkimet në ujëra mund të vijnë nga: • Derivatet, vajrat dhe lubrifikantet të ndryshme të cilat mund të derdhen nga makinat prodhuese; • Pastrimi i ambientit në rast të shkarkimit të çimentos së lëngshme, kryesisht nga ndërprerja e punës për shkak të ndërprerjeve të energjisë elektrike ose avari të tjera; • Në rastet e pastrimit të automjeteve të transportit në ambientin e kantierit, larja e auto-betonierëve dhe e materialit të gurit gëlqeror; • Ujërat e ujitjes së sheshit të qarkullimit të automjeteve;

		• Ujerat e përdorur për ambientet higjeno-sanitare të ambientit të stafit; • Ujerat nga shpëlarja e materialit nga reshjet; Ndikimi i këtij aktiviteti në ujera konsiston në ujerat e pastrimit të ambientit të punës. Gjatë procesit teknologjik, uji në ambient shkarkohet vetëm gjatë shpëlarjes së makinerive. Ky ujë grumbullohet në gropa septike dhe pas trajtimit të mirëfilltë, rikthehet prapë në proces teknologjik.
5.4.	Emisionet e ujërave të ndotura – treguesi i emisioneve kryesore	Nuk ka bërë matjen e cilësisë të ujit për të përcaktuar emisionet e ujërave të ndotura - treguesin e emisioneve kryesore, koncentrimet dhe sasinë vjetore.
5.5.	Trajtimi i ujërave të ndotura	Kemi ndërtuar sistemin për grumbullimin duke bërë ndërtimit të gropës septike e cila bënë trajtimin e ujrave nga procesi teknologjik.
5.6.	Kontrolli dhe matjet	Kompania bënë kontrollin dhe matjet e shkarkimit të ujërave sipas kërkesës që dalin nga Leja Ujore për shkarkimin e ujërave.
5.7.	Raportimi	Kompania nuk bënë raportim mirëpo pas që jemi pajisjes me leje për shfrytëzimin dhe shkarkimin e ujërave do të raportoj tek Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore – ARPL për shkarkimet në ujëra.
5.8.	Leje ujore për shfrytëzimi të ujit	Kemi marr Lejes Ujore për shfrytëzim të ujit. Me date 11.10.2021.
5.9.	Leje ujore për shkarkimin e ujërave	Kemi marr Lejes Ujore për shkarkim të ujit. Me date 11.10.2021.
5.10.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ujërave	Kompania ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për zvogëlimin e ndotjes së ujërave si: ndërtimi i gropës sedimentuese për trajtimin e ujrave.

6. ZHURMA		
6.1.	Burimet	Gjate funksionimit, zhurma si rezultat i teknologjisë së prodhimit të betonit, do të ketë një karakter lokal dhe nuk do të ketë ndikim në zonat e banuara. Zhurma do të krijohet nga makineritë dhe pajimet e procesit të prodhimit të betonit, automjetet transportuese dhe automjete të tjera. Sidoqoftë, aktivitetet që zhvillohen në këtë biznes nuk pritet që të tejkalojnë nivelin e lejuar të zhurmës. Zhurma dhe vibrimet që krijohen gjatë punës nuk pritet të ndikojnë në popullatën lokale. Po ashtu gjatë zhvillimit të veprimtarisë nuk ka aktivitete që zhvillohen gjatë natës që mund të ndikonin në krijimin e zhurmave. Sa i përket zhurmave, ato janë të ndjeshme vetëm brenda ambienteve të fabrikës dhe nuk janë problem për mjediset e jashtme dhe fqinjët.
6.2.	Kontrolli dhe matjet	Nuk kryen aktivitete të kontrollit dhe matjeve të zhurmës.
6.3.	Raportimet	Kompani nuk bën raportime në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, mirëpo nëse kërkohet në të ardhmen do të raportojmë, duke respektuar kërkesat e autoriteteve mjedisore dhe legjislacionin në fuqi.

7. TOKA		
7.1.	Ndikimet në tokë	Ndikimet ne toke jane minimale a po fare hiq, ndikimet ne toke mund te vije ne raste ekstreme ku kemi ndonje prishje te rende te makinerive.

		Gjate fazës së operimit – prodhimit të betonit, ndikime negative në tokë paraqiten nga mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të ndryshme; si dhe nga mbetjet e ushqimit dhe paketimet që mund të rezultojnë nga ai numer i vogël i punëtorve. Ndikim tjetër në tokë mund të vie edhe nga depozitimi i pluhurave të rezultuara nga agregati dhe çimentoja, si dhe ndikimet nga mbeturinat e ngurta dhe të lëngëta që krijohen nga larja e makinave prodhuese, auto-mikserëve, dhe automjeteve tjera transportuese dhe ndotja e dheut paraqitet si pasojë e sedimentimit të ndotjeve që sjellen përmes ujrave sipërfaqësore që vijne nga sipërfaqet e platosë.
7.2.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë	Në dobi të minimizimit të ndikimeve në tokë, pjese brenda hapësirës së punës janë shtruar me zhavorr dhe me beton. Për të parandaluar dhe zvogëluar ndikimet në tokë, gjatë operimit të impiantit dhe prodhimit të betonit, janë ndërmerre masat si në vijim: ▪ Të gjitha pajimet, stabilimentet e nevojshme për procesin e prodhimit të mirëmbahen dhe kontrollohen rregullisht; ▪ Filtrat e silosit të çimentos kontrollohen dhe nëse janë dëmtuar të ndërrohen; ▪ Të kontrollohen transportuesit si dhe shiritat transportues. Vendet e lidhjes së gypave duhet të jenë të puthitura mirë në mënyrë që të parandalohet rrjedhja e materialeve; ▪ Bëhet betonimi i platosë ku bëhet vendosja e pajimeve për prodhimin e betonit, gjeneratori, depot e vajrave e lubrifikantëve dhe të pajimeve tjera, si mjete sekondare të punës;

		▪ Ndërrimi i vajrave të makinave të bëhet në auto-mekanik ▪ Mbeturinat e ngurta grumbullohen dhe klasifikohen sipas llojit dhe përbërjes. Ato që nuk mund të ripërdoren apo të shiten, dërgohen në deponime regjionale të mbeturinave; ▪ Në zonë nuk lejohet shtimi, ndërrimi, vendosja e vajrave apo karburanteve; ▪ Mbeturinat komunale vendosen në kontejner adekuat të mbuluar me kapak, dhe është bërë marrëveshje me kompaninë komunale për mbledhje të mbeturinave; ▪ Përdoren makineri të cilat teknikisht janë të kontrolluara, veçmas nuk do të lejohen makineri me rrjedhje vaji; ▪ Është ndërtuar gropa septike, në të cilën grumbullohen ujërat e impiantit dhe trajtohen, ku në gropë bëhet fundërrimin i grimcave në mënyre që uji të përdoret sërish në procesin e prodhimit.
7.3.	Përshkrimi i rehabilitimit të zonës pas përfundimit të aktivitetit	Objektet ekzistuese do të largohen nga lokacioni, bazamentet si dhe platot nga betoni do të shkatërrohen, imtësohen dhe do të dërgohen në deponi të materialeve inerte. Pastaj do të bëhet zëvendësimi me një shtresë të humusit prej 0.5 m trashësi, të analizuar nga aspekti agrokimik, pastaj do të bëhet ngjeshja e shtresës së humusit, ashtu që do të krijohet një substrat i favorshëm për rikultivim ku do të vendoset për llojin e drunjtëve që do të mbjellën.

8. MENAXHIMI I MBETURINAVE

8.1.	Përshkrimi i llojit të mbeturinave dhe klasifikimi sipas Katalogut shtetëror të Mbeturinave	Mbeturina komunale deponohen përkohësisht në kontejner dhe pastaj bartën me kamionë nga kompania e licencuar, e cila i dërgon në deponinë regjionale për deponim të mbeturinave.
8.2.	Përshkrimi i magazinimit apo deponimit të mbeturinave	Kompania nuk bën magazinimin e përkohshëm të mbeturinave, mbeturinat e ngurta komunale grumbullohen, klasifikohen dhe vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim, pastaj merren nga kompania e mbeturinave.
8.3.	Përshkrimi për trajtim, përpunim dhe riciklim të mbeturinave	Nuk bën trajtim, përpunim dhe riciklimi të mbeturinave.
8.4.	Dërgimi për trajtim dhe riciklim të operatori tjetër – kontratë me kompaninë me leje përkatëse	Kompania nuk bën trajtim, përpunim dhe riciklimi të mbeturinave.
8.5.	Plani për menaxhimin e mbeturinave	Kompania, klasifikimin dhe mënyrën e magazinimit të përkohshëm të mbeturinave, e bën në bazë të rregullave dhe kushteve të përcaktuara me Ligj të mbeturinave, Nr.04/L-060. Mbeturinat e ngurta komunale grumbullohen, klasifikohen dhe vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim, me qëllim të mbrojtjes së tokës dhe ujërave nëntokësore.
8.6.	Raportimi	Nuk bëhet raportim lidhur me menaxhimin e mbeturinave pasi që kompania mbeturinat e grumbulluara komunale i merr kompania e licencuar për menaxhim me

		mbeturina.
9. RREZIKU NGA AKSIDENTET		
9.1.	Plani për pengimin e aksidenteve në rast të rrezikut/ plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm	Kompania e ka planin për pengimin e aksidenteve në rast rreziku si dhe planin e intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm.
9.2.	Përdorimi i substancave të rrezikshme kimike dhe preparateve, planifikimi i masave për zëvendësimin e tyre	Kompania, nuk përdor substancave të rrezikshme kimike dhe preparate.
9.3.	Masat për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave	Kompania, ka ndërmarr këto masa për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave: -Kompania ka siguruar pajisje kundër zjarrit si dhe enët me rërë.
9.3.1.	Raporti mbi gjendjen e sigurisë	Kompania nuk ka hartuar raportin për gjendjen e sigurisë.
9.3.2.	Plani për mbrojtjen nga zjarri	Nuk ka hartuar planin për mbrojtjen nga zjarri.
10. MASAT NË RASTET E PUNES JO STABILE TË IMPIANTIT		
10.1.	Ndërprerja momentale e punës së impiantit	Ndërprerja momentale e punës së impiantit mund të ndodhë në rastet e rrjedhjeve aksidentale të derivateve dhe vajrave, nëse kemi defekte, deri në sanimin e gjendjes dhe kthimin e tyre në funksion, si dhe në rastet aksidentale të shkaktimit të zjarrit.

10.2.	Ndërprerja e punës	Kompania nuk ka planifikuar ndërprerjen e punës, mirëpo nëse vjen deri te ndërprerja e punës, kemi bërë planin e rehabilitim dhe ri kultivimit.
11. NDIKIMI I MUNDSHËM I NDOTJES NË SHËNDETIN E NJERIUT		
Ndikimi i mundshëm i ndotjes në shëndetin e njeriut është shumë i vogël, pasi që Kompania – për prodhimin e betonit në fshati Nakell komuna e Pejës, ka ndërmarr të gjitha masat për zvogëlimin e ndikimeve në shëndetin e njeriut.		

Përsoni përgjegjës për mjedis

Emri Mbiemri Sami Kastrati

Nënshkrimi

Përsoni përgjegjës i kompanisë

Emri Mbiemri Sami Kastrati

Nënshkrimi
